



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 31 janar 2025

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: dhjetor, 2024

- Në dhjetor të vitit 2024, norma mesatare e interesit të totalit të kredive është 5,30% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,06 p.p., përkatësisht 0,17 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,05 p.p., përkatësisht 0,38 p.p. dhe shënon 2,17%.
- Norma mesatare e interesit të kredive të reja², këtë muaj, është më e ulët për 0,40 p.p., përkatësisht 0,79 p.p., në bazë mujore dhe vjetore dhe është 4,42%. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja shënon 2,78% dhe shënoi rënie mujore prej 0,02 p.p., përderisa në nivel vjetor u rrit për 0,41 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të totalit të kredive dhe depozitave të reja

	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024	11.2024	12.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38	5.36	5.30
Korporatat	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09	5.05	4.96
Amviseritë	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66	5.66	5.63
Kreditë e reja	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81	4.82	4.42
Korporatat	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65	4.68	4.39
Amviseritë	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17	5.03	4.47
Depozitat	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07	2.12	2.17
Korporatat	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42	2.68	2.69
Amviseritë	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02	2.05	2.10
Depozitat e reja	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84	2.80	2.78
Korporatat	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75	2.43	2.59
Amviseritë	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89	2.88	2.83

Burimi: BPRMV-ja.

¹ Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


² Lidhur me normata e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Lëvizjet e tilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

1. Norma të interesit në sektorin korporativ³


- Këtë muaj, norma mesatare e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ në bazë mujore është më e ulët për 0,09 p.p. dhe shënon 4,96%. Kështu, rënia rezulton nga rënia e të gjitha komponentave: normat e interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për përkatësisht 0,09 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,08 p.p.). Në krahasim me dhjetorin e vitit të kaluar, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,37 p.p.




Burimi: BPRMV-ja.



- Në dhjetor të vitit 2024, norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ është 4,39% dhe në bazë vjetore është ulur për 0,29 p.p.. Ndryshimi në rënie është rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,42 p.p.), përderisa normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe kredive në valutë të huaj janë rritur (për 0,34 p.p. dhe 0,23 p.p., respektivisht). E analizuar në bazë vjetore, norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ shënoi rënie prej 0,91 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.





³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ, këtë muaj, është më e lartë për 0,01 p.p. dhe shënon 2,69%. E analizuar sipas strukturës valutore, ndryshimi mujor është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,05 p.p., përkatësisht dhe 0,03 p.p.), në kushte të rënies së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,07 p.p.). Duke krahasuar në nivel vjetor, kjo normë e interesit është më e lartë për 0,63 p.p.
- Në dhjetor, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ shënon 2,59% dhe në bazë mujore është rritur për 0,16 p.p. Rritja është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj pa klauzolë valutore (për 0,17 p.p., përkatësisht 0,14 p.p.), përderisa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë të pandryshueshme. E analizuar në bazë vjetore, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar të sektorit korporativ është rritur për 0,40 p.p.

2. Norma të interesit tek amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV-ja.

- Këtë muaj, norma e interesit e totalit të kredive për amvisëritë shënon rënie mujore prej 0,03 p.p. dhe shënon 5,63%. Rënia është rezultat i uljes së normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,04 p.p., përkatësisht 0,01 p.p.), në kushte të normave të interesit të pandryshuara të kredive në valutë të huaj. Norma e interesit e totalit të kredive për amvisëritë, në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, shënoi rritje prej 0,04 p.p.



⁴ Në grafikon që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Në dhjetor, norma mesatare e interesit për kreditë e sapomiratuara për amvisëritë shënon 4,47% dhe në bazë mujore është më e ulët për 0,56 p.p. Kështu, rënia është rezultat i të gjitha komponentave: normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,74 p.p.), normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,33 p.p.) dhe normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,13 p.p.). Në bazë vjetore, norma e interesit të kredive të sapomiratuara për amvisëritë është ulur për 0,55 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.

- Norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive, këtë muaj, shënon 2,10% dhe në bazë vjetore është rritur për 0,05 p.p. Rritja në baza mujore është për shkak të rritjes së të gjithë komponentëve: normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,07 p.p.), normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,04 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave me klauzolë valutore (për 0,03 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë është rritur për 0,34 p.p.
- Në dhjetor, norma e interesit e depozitave të sapopranuara të amvisërive⁶ ka rënë për 0,05 p.p. në bazë mujore dhe shënon 2,83%. Rënia mujore është për shkak të uljes së normave të interesit për depozitat në valutë të huaj (për 0,16 p.p.) dhe të normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). Kështu, këtë muaj bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Norma e interesit e depozitave të sapopranuara të amvisërive është rritur për 0,14 p.p. në bazë vjetore.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhëshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit 28 shkurt 2025 (mesatare referuese, përfshirë janarin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235, lok. 108/110.